

# REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

## RREGULLORE

Nr \_\_\_ date \_\_\_\_\_ 2003

### PER ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BRENDSEHEM TE MINISTRISE SE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

Ne mbeshtetje te nenit 119 te Kushtetutes, Ligjit nr. 8549, date 11.11.1999 "Statusi i Nepunesit Civil" dhe te V.K.M. nr.103, date 04.02.1998 "Per rregullat e pergjithshme te punes ne administraten shteterore" Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit e krijuar me Dekretin nr. 3259, date 15.02.2002 te Presidentit te Republikes se Shqiperise per perberjen e Qeverise, funksionon sipas kesaj Rregulloreje:

#### ***I. Dispozita te Pergjithshme***

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit vepron mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, si dhe ne aktet ligjore dhe nenligjore.

Objekti i veprimtarise se Ministrise se Transportit dhe Telekomunikacionit , ne perberje te struktures se Qeverise eshte :

- Pergatitja dhe zbatimi i objektive te politikave ekonomike te Qeverise per zhvillimin e transportit dhe telekomunikacionit ne te gjithe elementet perberes te tij (infrastruktura, mjete, operim, etj) ne shkalle kombetare e nderkombetare.
- Hartimi i politikave te zhvillimit te transportit rrugor, hekurudhor, detar, ujor e ajror, ndjekja dhe zbatimi i ketyre politikave ne hallkat e varesise.

- Percaktimi i tendencave dhe i prirjeve nga analizat e llojeve te transportit dhe telekomunikacionit mbi bazen e statistikave dhe sistemeve te informacionit ne transport dhe telekomunicacion dhe hartimi i treguesve makro-ekonomike te zhvillimit te pergjithshem te transportit afatshkurter dhe afatgjate, hartimi, zberthimi dhe ndjekja e treguesve te projektprogrameve ekonomike financiare, te investimeve, te kontigjentit te punonjesve te sektorit publik etj.
- Grumbullon projektplanet vjetore te njesive shteterore ne varesi te saj per hartimin e projektprogrameve makro-ekonomike te deges se transportit dhe mbikqyr pasqyrimin e parametrave e te treguesve te strategjive te zhvillimit te transportit dhe telekomunikacionit.
- Negocion dhe bashkerendon punen me Ministrite e tjera dhe institucionet nderkombetare financiare e shtete te ndryshme per sigurimin e burimeve te financimit te domosdoshme, ne menyre qe te krijoje mundesi zhvillimi dhe harmonizimi te llojeve te transportit per te mbeshtetur zhvillimin e ekonomise se vendit, permiresimin e levizjes se pasagjereve dhe te kerkesave te transportit evropian.
- Drejton, menaxhon, supervizon dhe vendos standarde teknike te infrastruktures se rrjeteve rrugore e hekurudhore, te porteve, pontileve e kalatave ( ne digat e hidrocentraleve) dhe aeroporteve.
- Shqyrton dhe propozon burimet e financimit te brendshem e te jashtem ( me donatore te huaj) te harmonizuar me burimet ekonomike te transportit per te mbuluar nevojen e zhvillimit te transportit, si dhe ben rishperndarjen sipas llojeve te transportit me destinacion per investime themelore ne transport per mirembajtjen e infrastruktures e teknikes se transportit dhe per subvencione ne transport.
- Zhvillon hapesiren e inisiatives se lire private ne aktivitetet e sherbimit te llojeve te transportit, si dhe krijon kushtet per nje konkurrence te drejte ndermjet llojeve te transportit, ne veçanti ne transportin e udhetareve ( autobuse, mikrobuse e taksi) nepermjet ndertimit te sistemit fiskal vetveprues e deri ne hartimin e tarifave tavan, zhvillimin e kompeticionit ne sistemin e licensimit etj.
- Harton platformen e privatizimit te aktiviteteve te sektoreve strategjike dhe te sektoreve te tjere ne transport, si dhe pergatit e krijon kushte per transferimin e pronesise shteterore ne prone private.
- Drejton dhe synon te permiresoje, zgjeroje dhe zhvilloje sherbimet e informacionit ne transport per sigurimin e burimit te te dhenave te gjithanshme e te vazhdueshme per drejtimin e transportit; per krijimin e kushteve lehtesuese te te gjitha perdoruesve dhe operuesve te transportit vendas e te huaj, si dhe te pershtatshme e te adaptueshme per tu inkuadruar ne sistemet e informacionit te transportit evropian.

- Percakton dhe vendos standarte per te gjithë llojet e mjeteve te transportit dhe organizon drejtimin e kontrollin shteteror te sigurise teknike ne sferen e shfrytezimit.

-Percakton dhe miraton dokumentacionin teknik dhe ekonomik te domosdoshem per kryerjen e procesit te transportit per te gjithë llojet e mjeteve te transportit.

- Organizon kontrollin ekonomik financiar dhe administrativ ne institucionet dhe njesite ekonomike ne varesi te Ministrise.

- Harton politiken e zhvillimit te burimeve njerezore te transportit dhe telekomunikacionit si dhe organizon e drejton pergatitjen dhe kualifikimin e specialisteve ne sistemin e transportit dhe per secilin lloj transporti.

- Zhvillon negociimin , kryen pergatitjet dhe ben nenshkrimin ( me autorizim te organeve kompetente) te marreveshjeve te transportit sipas llojeve me shtete te ndryshme duke rregulluar marrdhenie nderkombetare ne baze te legjislacionit kombetar e nderkombetar, si dhe i referohet rekomandimeve te Komunitetit European dhe te organizatave nderkombetare te transportit dhe telekomunikacionit , ne te cilet vendi aderom dhe ndjek zbatimin e tyre.

- Kryen negociimet per zgjerimin e bashkepunimit nderkombetar ne fushen e transportit, ben pergatitjet e domosdoshme per zgjerimin e aderimit te vendit ne organizatat nderkombetare te transportit dhe ndjek zbatimin e tyre.

- Pergatit nje sistem ligjor e rregullues, sipas kerkesave e standardeve Europiane.

- Pergatit projektligje dhe projekt akte nenligjore per permiresimin e zhvillimit te llojeve te transportit, te shtrirjes se teknologjise e te standardeve te reja ne sferen e operimit te transportit te rregullave e te standardeve te reja ne fushen e teknikes se prodhimit, sherbimit e te mirembajtjes se mjeteve te transportit.

- Kryen, permireson dhe zhvillon reformen institucionale ne sektoret e transportit, ne transformimin e pergatitjen shkalle-shkalle te institucioneve te transportit dhe telekomunikacionit, ne perputhje me ato te vendeve te zhvilluara.

## **II. Struktura Organizative**

Per kryerjen e veprimtarise se saj dhe realizimin e objektivave, Ministria ka kete strukture organizative:

### **a- Niveli Politik**

- Ministri
- Zevendesministri
- Kabineti

### **b- Sherbimi Civil**

- Sekretari Pergjithshem
- Drejtoria e Pergjithshme e Transportit Tokesor
- Drejtoria e Transportit Rrugor
- Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurise Rrugore
- Drejtoria e Transportit Hekurudhor
- Drejtoria e Transportit Ajror
- Drejtoria e Transportit Detar
- Drejtoria e Integritimit dhe Marredhenieve me Jashte
- Drejtoria Juridike
- Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve
- Drejtoria e Pergjithshme e Poste – Telekomunikacionit
- Drejtoria e Pergjithshme e Programimit
- Drejtoria e Kontrollit Financiar
- Drejtoria e Inspektimit dhe Monitorimit te Punimeve
- Njesia e Menaxhimit te Projekteve (PMU Phare Cross Border)

### **c- Institucione ne Varesi**

- Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve
- Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor
- Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil
- Kapiteneria e Pergjithshme e Porteve
- Instituti i Studimeve te Transportit
- Inspektoriati Hekurudhor

Objekti i veprimtarise dhe rregullat e funksionimit te drejtorive te pergjithshme dhe institucioneve te varesise percaktohen me akte te veçanta.

Struktura organizative, numri i punonjesve, statuti dhe rregullorja e funksionimit te tyre miratohet nga Ministri.

Sipas kushteve te kontrates te lidhur me Ministrin (PAO), funksionojne edhe Njesite e Projekteve te financimeve te huaja (PIU), jashte struktures se ministrise.

- Ministria per çeshtje te rëndesishme te veprimtarise se saj, me Urdher te Ministrit krijon organe konsultative, si:

- Keshilli i Politikave te Ministrise se Transportit dhe Telekomunikacionit
- Grupi i Riorganizimit Institucional
- Grupi i Menaxhimit te veprimtarive operative
- Grupe te ndryshme pune, me afate te caktuar, ( duke perfshire edhe konsulencen shkencore, etj).

Detyrat dhe perberja e ketyre organeve konsultative caktohen ne aktin e krijimit te tyre.

### **III. Misioni i organeve drejtuese te Ministrise**

#### **A – Niveli Politik**

##### **1. Ministri**

Ministri eshte drejtuesi politik i ministrise.

Qellimi i punes se Ministrit eshte zbatimi i Kushtetutes dhe dispozitave ligjore per te siguruar zbatimin e politikave qeveritare ne fushen e transportit dhe telekomunikacionit me ndersmeri, efektivitet dhe ne pershtatje me etiken. Te jape kontribut si Antar i Keshillit te Ministrave ne vleresimin dhe zhvillimin e metejshem te programeve qeveritare si dhe te ndaje pergjegjesine kolektive ne vendimet e marra nga Keshilli i Ministrave.

Perfaqeson Ministrine ne çeshtjet kombetare e nderkombetare per transportin dhe telekomunikacionin dhe pergjigjet per veprimtarine e saj duke zbatuar kompetencat e caktuara ne ligj dhe aktet nenligjore.

- Nxjerr urdhera dhe udhezime
- Miraton Rregulloren e Brendshme te Ministrise

Propozon dhe krijon, bashkon dhe shkrin institucione ne varesi te Ministrise nepermjet akteve nenligjore perkatese.

- Vendos per çeshtjet themelore te veprimtarise dhe te objektit te Ministrise
- Emeron Shefin e Kabinetit, Keshilltaret e Ministrit, drejtoret e zevendesdrejtoret e institucioneve ne varesi te Ministrise dhe drejtoret e drejtorive ne Drejtorite e Pergjithshme.
- Miraton dhe vendos per te gjithë materialet qe i paraqiten Qeverise nga ana e aparatit te Ministrise si dhe nga institucionet ne varesi te saj.
- Miraton mendimet dhe verejtjet per projektligjet, projektaktet nenligjore te pergatitura nga Ministrite e tjera.
- Miraton planet e punes te Ministrise, programe pune per çeshtje te veçanta, tematiken vjetore te Ministrise .
- Miraton perdorimin e mjeteve financiare te Ministrise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

- Miraton organet konsultuese te Ministrise dhe grupe te veçanta per çeshtje te rëndesishme te transportit ( perfshire dhe konsulencen shkencore), detyrat dhe te drejtat e te cilave percaktohen ne aktin e miratimit.
- Miraton projektet per lidhjen e Marreveshjeve Nderkombetare te Transportit dhe Telekomunikacionit dhe aderimin ne organizatat nderkombetare te transportit dhe telekomunikacionit.
- Ministri sipas rastit, ne mungese dhe/ose me porosi delegon punen zevendesministrit.
- Drejton punen e Sekretarit te Pergjithshem ne menaxhimin e aktiviteteve te ministrise.

## **2. Zevendesministri**

Zevendeson Ministrin ne mungese dhe me porosi te tij.

Qellimi i punes se zevendesministrit eshte ti siguroje Ministrit koordinim dhe keshillim politik, te mbuloje formulimin dhe zbatimin e politikës ne fusha specifike te veprimtarise se Ministrise, sipas detyres se ngarkuar nga Ministri.

Pergjegjesite kryesore ( sipas delegimit qe ben ministri ) :

- Pergjegjesi per aspekte te caktuara te politikës qeveritare qe lidhen me ministrine.
- Pergjegjesi per koordinimin e çeshtjeve politike specifike dhe percaktimin e objektiveve te Ministrise per rezultatet qe duhen arritur.
- Drejton Komisionin e Transportit Rrugor te percaktuar ne Ligjin “Per transportet rrugore”.
- Drejton Komisionin e Shpronësimeve sipas VKM nr.126, date 23.03.2000 “Per perberjen dhe procedurat e punes se Komisionit te Posaçem te Shpronësimit”.
- Organizon zhvillimin e takimeve me drejtuesit e sindikatave dhe bashkerendon me drejtorite perkatese per dhenien rruge zgjidhje problemeve qe jane ne kompetence te Ministrise dhe per problemet e tjera te drejtorive te perkatesise i drejtohet organeve kompetente per zgjidhjen e tyre.

## **3. Kabineti,**

Kabineti vepron si nje strukture e vecante ne ndihme dhe funksion te Ministrit.

Ndjek dhe drejton pergatitjen dhe perpunimin e njoftimeve dhe te materialeve te tjera qe i parashtrihen Ministrit.

Pergjigjet per pergatitjen e materialeve te rëndesishme per Ministrin, kryesisht per mbledhjet e Qeverise dhe organeve te tjera.

Koordinon dhe organizon kontakte zyrtare me Ministrin, te drejtuesve te institucioneve brenda vendit dhe misionet nderkombetare.

Organizon zhvillimin e mbledhjeve sipas tematikave e programeve te punes te Ministrit, te organeve e organizmave te tjera konsultative, te takimeve te zakonshme te Ministrit, si dhe per takime te rëndesishme te veçanta si borde, grupe pune etj.

Ne takimet e Ministrit me institucionet , organizmat, sindikatat dhe qytetare te ndryshem, evidenton dhe shqyrton problemet dhe ndjek zgjidhjen e tyre.

Pergatit korrespondencen kryesore dhe te rendesishme per Ministrin.

Kryen marrjen dhe dhenien e informacionit per organet e shtypit, masmedias elektronike, apo te mjeteve te komunikimit masiv, propagandimin e aktivitetit te ndryshem te Ministrise , zhvillimin e konferencave te shtypit, te Ministrit si dhe i pergjigjet artikujve te ndryshem neper gazeta apo organe te tjera te masmedias.

Kryen pergatitjen e raporteve ne zhvillimin e analizave periodike dhe vjetore te Ministrise.

### **3.1. Shefi i Kabinetit**

Drejton ne bashkerendimin, pergatitjen dhe perpunimin e materialeve dhe njoftimeve qe i parashtrohen Ministrit per ne Qeveri apo ne organet e tjera te larta shteterore.

Organizon zhvillimin e mbledhjeve te drejtuar nga Ministri, kohen, rendin e dites apo ceshtje te tjera te ndryshme.

Koordinon dhe organizon kontakte zyrtare te ministrit me drejtues te institucioneve brenda vendit, te misioneve nderkombetare dhe harton plan-kalendarin per takimet kryesore te Ministrit.

Evidenton dhe raporton zgjidhjen e problemeve te dala nga takimet e Ministrit me institucione, organizata, sindikata dhe qytetare te ndryshem.

Ndjek pergatitjen e korrespondences kryesore dhe te rendesishme ne adrese te Ministrit dhe detyrave te lena nga ana e tij.

Koordinon me Sekretarin e Pergjithshem kontributet e drejtorive dhe strukturave te varesise, ne funksion te misionit te ministrise, programit dhe detyrave te dhena nga Ministri.

-Kryen veprimet Protokollare te Ministrit

### **3.2 Keshilltari i Ministrit.**

Shqyrton materialet qe i paraqiten Ministrit, ben verejtjet, sugjerimet dhe keshillon rrugезgjidhjet e nevojshme.

Pergatit materiale te ndryshme te rendesishme e permbledhese te natyres se konkluzioneve, diskutimeve etj. te Ministrit per ne organet e ndryshme shteterore, konferenca, simpoziume etj.

Verifikon e kontrollon sipas porosive te Ministrit per ceshtje te vecanta te veprimtarise te Ministrise.

Pret persona ne raste te vecanta qe kerkojne takim me Ministrin ( me porosi te Ministrit) dhe bashkerendon materialet e drejtorive per veprim te Ministrit.

Keshillon Ministrin ne ceshtje te ndryshme.

### **3.3 Zedhenesi i Shtypit.**

Ben propagandimin, marrjen ose dhenien e informacionit organeve te shtypit apo mjeteve te komunikimit masiv per veprimtarine e Ministrise.

Ndihmon ne shkrimet e artikujve te ndryshem dhe pergjigjet neper gazeta apo organe te tjera te masmedias.

Pergatit konferencat e shtypit, takime ose intervista me gazetaret e ndryshem me titullaret e Ministrise.

Bashkerendon me organet e medias dhe te shtypit per te pasqyruar veprimtarine e Ministrise per delegacionet qe lidhen me çeshtjet nderkombetare te transportit.

Pergatit informacionin javor e periodik per veprimtarite e rendesishme te Ministrise, mbi bazen e grumbullimit te informacioneve te njepasnjeshme nga drejtorite per udheheqjen e Ministrise dhe per publikim ne medja.

Bashkerendon me organet e medias elektronike ( drejtuesit e Radio-Televizoreve) dhe te shtypit, etj per zhvillimin e diskutimeve rreth çeshtjeve te veprimtarise se transportit ne shkalle Ministrie e deri ne nivel drejtorie si edhe per sensibilizimin e aktiviteteve te rendesishme te ligjshmerise dhe te rregullave te ndryshme ne transport.

Evidenton ne shtypin e perditshem çeshtjet ekonomike te rendesishme qe lidhen me veprimtarine e Ministrise dhe bashkerendon me drejtorite perkatese per pergatitjen dhe dhenien e pergjigjeve.

### **4. Sekretari i Ministrit ( Zevendesministrit ).**

Organizon, ndjek e zhvillon takimet e planifikuara per Ministrin ( zevendesministrin).

Transmeton porosi dhe informacione si me personelin brenda Ministrise ashtu dhe me institucione te tjera e persona te trete.

Kontrollon e pergatit dosjen e materialeve qe i dergohen Ministrit ( zevendesministrit ) per shqyrtim.

Pergatit dosjet per Ministrin ( zevendesministrin ) me materialet e korrespondences etj, dhe rakordon me protokollin sipas shenimeve te Ministrit (zevendesministrit) .

Regjistron dhe evidenton dhenien e pergjigjeve te letrave te popullit ne adrese te titullareve.

I paraqet çdo dite axhenden e problemeve dhe detyrave ditore te percaktuar me perpara.

Kujdeset per pajisjet dhe orendite e kabinetit ( zyrave) dhe i merr ne dorezim ato.

Nga pikpamja administrative e organizative e punes varen nga Shefi i Kabinetit.

## **B - Sherbimi Civil**

Sherbimi civil ne Ministrine e Transportit organizohet dhe funksionon sipas Ligjit nr. 8549, date 11.11.1999 "Statusi i Nepunesit Civil" dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij, duke percaktuar skemen e administrimit te ketij sherbimi.

### ***Sekretari i Pergjithshem***

Sekretari i Pergjithshem i Ministrise se Transportit dhe Telekomunikacionit eshte drejtuesi administrativ i Ministrise dhe raporton tek Ministri qe eshte drejtuesi politik.

Ai eshte nepunesi civil i nivelit me te larte drejtues ne ministri dhe eshte pergjegjes perpara ministrit per menaxhimin dhe koordinimin e aktiviteteve te ministrise.

Qellimi i punes, detyrat dhe kompetencat ne pergjithesi te Sekretarit te Pergjithshem percaktohen ne Udhezimin e Keshillit te Ministrave nr.1, date 13.06.2000 "Per strukturen e renditjes se puneve ne sherbimin civil, metodologjise perkatese dhe pershkrimin pergjithesues te rolit te Sekretarit te Pergjithshem ne kete sherbim".

### ***Sekretari i Pergjithshem kryen keto funksione:***

-Drejton dhe mbikqyr kryerjen e detyrave nga adminis trata, si dhe siguron bashkerendimin dhe bashkepunimin efektiv te te gjitha instancave, brenda dhe jashte ministrise.

-Drejton procesin e hartimit dhe nenshkrimin te akteve juridike te Ministrit .

-Administron marredheniet me institucionet e varesise dhe drejton procesin e vleresimit te projekt akteve te tyre qe dergohen ne ministri .

-Administron dhe organizon sherbimin e dokumentacionit, te levizjes se tij, te shperndarjes, te informatizimit dhe te administrimit te korrespondences qe vjen ne aparatit e ministrise.

-Mbulon te gjitha problemet e administrimit ekonomik financiar, te personelit dhe te sherbimeve teknike ne aparatit e ministrise.

-Pergatit dhe kontrollon respektimin e Organikes se Ministrise dhe fondit te pagave, sipas procedurave perkatese.

- Siguron kontrollin e standarteve profesionale per çdo vend pune.

- Mban nen kontroll organizimin e punes ne drejtim te strukturave te drejtorive dhe sektoreve, pershkrimin individual te vendit te punes dhe nivelit te punonjesve.

- Autorizon dhe aprovon zbatimin e procedurave te rekrutimit, promovimit, trainimit, emerimit etj. te personelit ne perputhje me ligjin “ Per Statusin e Nepunesit Civil”.
- Siguron ruajtjen e marrdhenieve konsultative me Ministrite e tjera dhe Aparatin e Keshillit te Ministrave, ne te gjitha nivelet e punes.
- Mbikqyr procesin e pergatitjes se buxhetit financiar, si dhe kontrollon zbatimin e tij.
- Siguron Ministrise se Transportit dhe Telekomunikacionit sistemet e nevojshme te teknologjise se informacionit ne menyre qe te menaxhohet dhe perdoret informacioni perkates.
- Negocion per sigurimin e burimeve financiare dhe materiale, duke patur parasysh prioritetet e Ministrise se Transportit dhe Telekomunikacionit; perdorimin eficient te burimeve ne dispozicion, nepermjet kontrollit te vazhdueshem te tyre.

#### **IV. Misioni i Drejtorive**

Per realizimin e objektivave dhe kryerjen e funksioneve te Ministrise misioni i drejtorive e njesive te tjera, ne perberje te struktures organizative te saj, eshte

##### **IV.1 Misioni i Drejtorise se Pergjithshme te Transportit Tokesor**

Drejtoria e Pergjithshme e Transportit Tokesor, per realizimin e objektivave dhe funksioneve te Ministrise, ne perputhje me programin e Qeverise, permbush detyrat e meposhtme:

- Harton dhe propozon strategjinë e zhvillimit të Transportit Rrugor dhe Hekurudhor, dhe mbi këtë bazë percakton politikat për zhvillimin e ketij transporti.
- Përcakton rregullat e administrimit të pronës brenda territoreve të stacioneve hekurudhore dhe të gjithë ndërtimeve publike në stacionet hekurudhore te Republikës së Shqipërisë.
- Drejton veprimtarinë studimore për përcaktimin e drejtimeve kryesore te zhvillimit te transportit tokesor nëpërmjet kryerjes së studimeve për periudha afat shkurtëra, afat mesme dhe afat gjata.
- Merr pjesë ne pergatitjen e legjislacionit për rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin normal të aktiviteteve në fushën e transportit rrugor dhe hekurudhor.
- Përcakton rregulla dhe udhëzime për transportin rrugor dhe hekurudhor te mallrave dhe udhëtareve.
- Nxjerr rregulla dhe udhëzime për regjistrimin dhe liçensimin e mjeteve te transportit rrugor;
- Përcakton rregullat që kanë të bëjnë me sigurinë rrugore dhe hekurudhore si dhe mënyrën e inspektimit të tyre;

- Merr pjese në forumet, komisionet dhe takimet e transportit ndërkombëtar rrugor dhe hekurudhor;
- Përcakton rregullat për mbrojtjen e mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e interesuara në zbatim të Konventave ndërkombëtare rrugore e hekurudhore si dhe mënyrën e zbatimit dhe kontrollit të këtyre rregullave;
- Përcakton rregulla që janë të lidhura me tregtinë me transport rrugor dhe hekurudhor;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Marrredheneve me Jashte dhe Juridike, përgatit marrëveshjet rrugore e hekurudhore me shtetet e tjera, që burojnë nga zbatimi i Konventave dhe Kodeve Ndërkombëtare të Transportit Rrugor dhe Hekurudhor;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Marrredheneve me Jashte dhe Juridike, përgatit dokumentacione për ratifikimin, bashkimin ose pranimin e Konventave Ndërkombëtare të Transporteve Tokesore si dhe përgatit rregullat kombëtare në zbatim të tyre;
- Ndjek zbatimin dhe kontrollin e të gjithë rregullave që burojnë nga Konventat Ndërkombëtare të Transportit Rrugor e Hekurudhor për të cilën kanë detyrime të gjitha shtetet dhe ndaj shkelësve të tyre njofton organizmat përkatëse ndërkombëtare.
- Bashkerendon punën dhe kryen lidhjen e ministrise me Drejtorinë e Përgjithshme të Sherbimeve të Transportit Rrugor, Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhes dhe hallkave drejtuese të shoqatave të transportit tokesor.
- Merr pjesë, duke bashkëpunuar me drejtoritë e tjera, në kryerjen e investimeve në sektorin e transportit rrugor dhe hekurudhor.

#### **IV.2 Misioni i Drejtorisë Transportit Rrugor**

- Hartimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i politikave të zhvillimit të transportit rrugor në përputhje të plotë me zhvillimin ekonomik të vëndit si dhe plotësimin e nevojave të popullsisë;
- Hartimi dhe përputhja e legjisllacionit tonë me direktivat e Bashkimit Europian;
- Ndjekja e realizimit të investimeve buxhetore në përputhje me programet e hartuara dhe të miratuara për infrastrukturën rrugore.
- Në bashkëpunim me drejtoritë të ministrisë dhe institucionet e tjera kryen veprimtari studimore në hartimin e politikave për transportin rrugor;
- Organizon punën e sektorëve në kuadrin e rezolutave dhe direktivave të CEMT-it;
- Merr masa për shmangien e situatave monopol në transportin e udhëtarëve dhe mallrave;
- Përcakton dhe propozon politikat e përmirësimit të infrastrukturës rrugore;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Marrredhënieve me Jashtë merr pjesë në hartimin e marrëveshjeve të reja dhe propozon ndryshime në ato të vjetra për transportet rrugore;
- Harton akte ligjore e nënligjore në fushën e transportit rrugor të udhëtarëve e mallrave;

- Shërben subjektet private në drejtim të licensimit në fushën e transportit të udhëtarëve e mallrave;
- Shqyrton e ndjek ankesat e ndryshme nga subjektet private lidhur me ecurinë e biznesit privat;
- Në bashkëpunim me institucione të tjera ndjek dhe zbaton ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore" e akteve nënligjore në zbatim të tij;
- Bashkëpunon me shoqatat e transportuesve për zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë ata.

### **IV.3 Misioni i Drejtorise se Qarkullimit dhe Sigurise Rrugore**

- Në kuadrin e zhvillimit të politikave sektoriale të Drejtorise se Përgjithshme të Transportit Toksor, harton planin e detajuar të veprimit për realizimin e objektivave kryesore për të bërë të mundur përmirësimet e nevojshme të kompleksit të komponenteve në shërbim të sigurisë së lëvizjes së përdoruesve të rrugës dhe mbrojtjes mjedisore nga mjetet rrugore.
- Punon për hartimin e kuadrit ligjor që buron nga legjislativi bazë i transportit në fushën e sigurisë rrugore. Analizon nëpërmjet monitorimit rezultatet e zbatimit të tyre dhe bën përmirësimet e nevojshme në përshtatje dhe me legjislativin e KE -se në këto fushë.
- Vlerëson dhe nxit politikën e investimeve nga burime të ndryshme financimi për të aritur objektivat në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të faktorëve që lidhen me sigurinë rrugore dhe mbrojtjen mjedisore nga mjetet rrugore.
- Në bashkëpunim me strukturat e varesisë të Ministrisë, si me sektorin e infrastrukturës së drejtorisë së transportit rrugor dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse jashtë saj, programon punën për verifikimin e gjendjes në drejtim të respektimit të dispozitave të Kodit Rrugor nga entet pronare të rrugëve dhe organet e Pushtetit Vendor, që kanë të bëjnë me organizimin e trafikut dhe sinjalitikes rrugore.
- Bashkëpunon me organe brenda dhe jashtë Ministrisë për të mundësuar organizimin e sistemit të informacionit për evidentimin e të dhenave që i shërbejnë analizës së gjendjes dhe shkaqeve të aksidentëve, vendeve të ndodhjes së tyre, si dhe evidentimin e të dhenave të tjera për situatën rrugore, mjetet dhe poseduesit e tyre, në kuadrin e krijimit të arkivave të rrugëve, regjistrimit të mjeteve dhe drejtuesve të mjeteve.
- Në bashkëpunim me DPSHTRr, kontribuon për krijimin e kushteve që bëjnë të mundur testimin e parametrave teknikë të mjeteve sipas standardeve të hartuara për këto qëllime në shërbim të sigurisë rrugore.
- Rishikon procedurat për kualifikimin e drejtuesve të mjeteve dhe të instruktorëve si dhe monitoron në nivel lokal dhe kombëtar, cilësinë e kushteve të mesimdhënies në autoshkollë si dhe procesin e kalimit në prova të kandidatëve për kategori të ndryshme të lejeve të drejtimit.
- Në bashkëpunim me institucionet që obligohen nga Kodi Rrugor kontribuon dhe ndjek në vazhdimësi realizimin e programit për formimin e edukatës qytetare në nivel shkollor dhe me format publicitare të sensibilizimit publik.

- Ne aspektin e funksionimit te sekretarise se Komitetit Nderministror te Sigurise Rrugore ( KNSRr ), ne bashkepunim me strukturat perkatese qe merren me problemet e sigurise rrugore si DPRr, DPSHTRr, Policia e Qarkullimit Rrugor, Kompanite e Sigurimeve dhe Institutin e Studimeve te Transportit, pergatit materialet e nevojshme qe ne periudha te caktuara do te shqyrtohen nga KNSRr, duke i shqyrtuar paraprakisht ne komisionin keshillimor te eksperteve.
- Ne bashkepunim me Institutin e Studimeve te Transportit mbikqyr ne vazhdimesi detyrimet qe Organet e Pushtetit Vendor kane per realizimin e projektimit dhe implementimit te projekteve per organizimin e trafikut dhe sinjalitikes rrugore per zonat urbane nen juridiksionin e tyre.
- Azhurnohet vazhdimisht me informacionin e institucioneve homologe per zhvillimet ne fushen e sigurise rrugore, te konventave nderkombetare, per t'i reflektuar ne programin e punes vjetore.

#### **IV.4 Misioni i Drejtorise Transportit Hekurudhor**

Drejtoria e Transportit Hekurudhor është në përbërje të strukturës organizative të Drejtorise së Përgjithshme të Transportit Tokesor në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

Drejtimet kryesore të punës së Drejtorisë janë si vijon:

- Hartimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i politikave te zhvillimit të transportit hekurudhor në përputhje me zhvillimin aktual të ekonomisë kombëtare dhe të nevojave të popullatës për transportin e mallrave e të udhëtarëve si për transportin e brendshëm ashtu dhe për transportin ndërkombëtar hekurudhor;
- Hartimi dhe përmirësimi në vijimësi i një legjislacioni sa me bashkëkohor e në përputhje me direktivat e Bashkimit europian, me synim nxitjen dhe menaxhimin optimal të transportit hekurudhor në përputhje me politikat sektoriale te hartuara.
- Nxitjen e programeve rajonale dhe programeve me donatore të huaj per kryerje studimesh dhe thithje fondesh per zhvillimet perspektive te transportit hekurudhor;
- Programimi dhe ndjekja e realizimit te investimeve buxhetore në përputhje me planet e studimet e zhvillimit të transportit hekurudhor.

Drejtoria realizon këto detyra:

- Kryen veprimtari studimore në hartimin e politikave të zhvillimit të transportit hekurudhor. Në bashkëpunim me drejtoritë ne dikaster, institucionet studimore brenda dhe jashtë vendit si dhe me subjektet që veprojnë në fushat përkatëse merr pjesë dhe ndjek hartimin e studimeve të feabilitetit dhe master -planeve për zhvillimin e transportit hekurudhor në tërësi dhe sipas zonave e koridoreve te veçanta të transportit.

- Mbështet, inkurajon dhe favorizon zhvillimin e trafikut tranzit duke i dhënë përparësi zhvillimit të transporteve multimodale në korridoret Lindje – Perëndim, Veri – Jug si dhe ato në drejtim të Kosovës;
- Organizon bashkëpunimin shumëdegësh në kuadrin e grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim për hartimin e legjislacionit të përshtatshëm e bashkekohor në fushën e transportit hekurudhor duke e harmonizuar atë me kushtet konkrete të vendit tonë, me legjislacionin në fuqi në vendet e Bashkimit Europian, me rezolutat e Konferencës Europiane të Ministrave të Transportit, me konventat e Organizatës Ndërqeveritare të Transportit Nderkombëtar Hekurudhor dhe të Organizatave të tjera ndërkombëtare ku vendi ynë është anëtar;
- Merr masa për mënjanimet e situatave monopol në fushën e shërbimeve të transportit me qëllim vendosjen dhe nxitjen e një klime të konkurrencës mbi bazën e formave të ndryshme të pronësisë të subjekteve transportuese;
- Bashkëpunon me Ministrinë e Ekonomisë, Hekurudhat Shqiptare dhe Drejtorinë e Programimit në Ministri për strategjite dhe hapat e privatizimit të sektorëve të ndryshëm të transportit hekurudhor në bazë të politikës së hartuar për këtë qëllim;
- Krijon kushte të favorshme për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe zhvillimin e transportit hekurudhor të mallrave e të udhëtarëve;
- Përcakton politikat e përmirësimit të infrastrukturave egzistuese të transportit hekurudhor dhe të zgjerimit e zhvillimit të infrastrukturave të reja;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë harton projekt - Marrëveshjet e reja në fushën e transportit hekurudhor ndërmjet shteteve si dhe propozon ndryshimet eventuale për marrëveshjet e nënshkuara;
- Ndjek në vazhdimësi amendamentet që ju bëhen Konventave për transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe të mallrave në të cilat Qeveria jonë është anëtare;
- Pergatiten materiale dhe sigurohet pjesëmarrja në mbledhjet e organizmave ndërkombëtare për probleme të ndryshme të transportit hekurudhor, të cilat kanë interes për vendin tonë drejt një integrimi të shpejtë në Transportin Europian.
- Në kuadrin e asistencave, ndihmave apo kredive dhënë shtetit shqiptar drejton dhe harton plane e programe në bashkëpunim me Drejtoritë specifike për detajimin e investimeve, trajnimin e personelit, temat për asistencat teknike në fusha të ndryshme, hartimin e termave të referencës për organizimin e studimeve, të tenderave të ndryshme dhe ndjek zbatimin e tyre.
- Ndjek zbatimin e politikave dhe programeve të Transportit në subjektet në vartësi si dhe bashkëpunon me organet e pushtetit lokal për probleme specifike. Organizon takime e konsulta për probleme të veçanta e të rëndësishme për harmonizimin e gjithë veprimtarisë në përputhje me legjislacionin dhe interesat sociale të vendit;
- Harton Projektligje, Projektvendime e udhëzime dhe ndjek e zgjidh gjithë problematikën që lind nga korespondenca me organet shtetërore eprorë, vartëse, të individëve apo shoqatave që kanë lidhje me transportin hekurudhor;

- Shqyrton dhe ndjek të gjitha problemet teknike të transportit hekurudhor që lidhen me gjëndjen aktuale të inventarit të mjeteve lëvizëse, të sistemeve të ndërlidhjes e të sinjalizimit si dhe ndjek në vazhdimësi politikën e miratuar për ecurinë në këtë fushë;
- Ndjek dhe zbaton punën e përditshme që buron nga rregullorja e brendshme e Ministrisë.

#### **IV.5 Misioni i Drejtorisë Transportit Ajror**

Ne zbatim të legjislationit në fuqi për Administratën Publike, për rritjen e efektivitetit të institucioneve publike si dhe në përputhje me ndryshimin strukturor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, është krijuar Drejtoria e Transportit Ajror në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

Drejtorja e Transportit Ajror është pjesë e administratës shtetërore brenda strukturës së Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

Ajo varet nga Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kryen funksionet e saj administrative e operacionale brenda juridiksionit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, në përputhje me legjislationin në fuqi dhe aktet normative që rregullojnë marrëdhëniet në administratën shtetërore.

Drejtorja e Transportit Ajror ushtron funksionet e saj në përputhje me hierarkinë ministrore të vendosur nga Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit dhe në bashkëpunim me Drejtoritë dhe strukturat e tjera ministrore.

Aktet ligjore e nën ligjore mbi bazën e të cilave ushtron kompetencat dhe funksionet Drejtoria e Transportit Ajror janë :

- Ligji 7877, dt. 30.11.1994 “Për Aviacionin Civil Shqiptar”;
- Ligji 8910, dt. 19.03.1998 “Për Sigurinë në Aviacionin Civil”;
- Ligji 8374, dt. 15.07.1998 “Për Përdorimin e Hapesirës Ajrore të RSH”;
- VKM dhe Udhëzimet e Urdhërave të Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit për Aviacionin Civil;

Dokumentacioni bazë mbështetës për ushtrimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Transportit Ajror do të jenë Anekset e Konventës së Chikagos në gjuhën Angleze ose në gjuhën Shqipe.

Titujt e Anekseve te Konventes se Chikagos jane :

- Aneksi 1 Licencimi i personelit te aviacionit
- Aneksi 2 Rregullat e ajrit
- Aneksi 3 Meterologjia
- Aneksi 4 Hartat aeronautike
- Aneksi 5 Njesite e matjes qe perdoren ne komunikimin toke –ajer.
- Aneksi 6 Operimi i avionit ne transportin ajror nderkombetar
- Aneksi 7 Nacionaliteti i avionit dhe rregjistrimi I avionit
- Aneksi 8 Certifikata e vlefshmerise teknike te avionit
- Aneksi 9 Lehtesirat e procedurave te ulje ngitjes dhe perdorimit te hapsires nga avioni
- Aneksi 10 Telekomunikacioni Aeronautik
- Aneksi 11 Sherbimi i Trafikut Ajror
- Aneksi 12 Kerkim Shpetimi i avionit
- Aneksi 13 Investigimi i avionit te aksidentuar
- Aneksi 14 Aerodromet
- Aneksi 15 Sherbimi Informativ Aeronautik
- Aneksi 16 Mbrojtja e ambientit nga niveli I zhurmave.
- Aneksi 17 Siguria e aviacionit kunder akteve te pa ligjeshme.
- Aneksi 18 Standartet per transportimin ajror te mallrave te rrezikshme

Lidhja Nr. 2 pasqyron gjithe strukturen e Bazes Ligjore (kombetare dhe nderkombetare) dhe te Literatures se Aviacionit Civil.

Drejtoria e Transportit Ajror eshte strukture organike e Ministrise se Transportit dhe Telekomunikacionit e cila ushtron funksionet ne zbatim te detyrave te meposhteme :

- Te hartoje strategjine e zhvillimit te Aviacionit Civil ne perputhje me objektivat e Qeverise dhe mbi kete baze percakton politikat e zhvillimit te saj ;
- Te programoje , mbeshtese dhe monitoroje programet afatmesme dhe afatgjata te Miratuara nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe Qeveria per zhvillimin e Aviacionit Civil kombetar, transportin ajror te pasagjereve dhe mallrave ;
- Te drejtoje veprimtarine studimore dhe te ndjeke mundesite e zgjerimit te transportit nderkombetar dhe te transportit te brendshem ajror, ne perputhje me politikat e zhvillimit te aviacionit civil;
- Ne bashkpunim me Drejtorine e Integritimit dhe Ceshtjeve Juridike dhe struktura te tjera te Aviacionit Civil, te ndjeke marredheniet e Dikasterit me

shtetet anetare te organizmave nderkombetare te Aviacionit Civil, te pergatise dokumentacionin dhe procedurat ne perpilimin e marreveshjeve bilaterale e traktateve multilaterale per ratifikimin ose aderimin ne to ;

- Te marre pjese ne pergatitjen e legjislacionit, implementimin e legjislacionit nderkombetar brenda legjislacionit kombetar dhe akteve normative qe rregullojne marredheniet e Ministrise me strukturat vartese dhe industrine e aviacionit civil;
- Te pergatise ne bashkpunim me struktura te Ministrise se Transportit dhe Telekomunikacionit akte normative per krijimin e lehtesirave te biznesit dhe levizjes se lire te pasagjereve e mallrave brenda dhe jashte vendit ;
- Te siguroje, monitoroje, ndjeke dhe analizoje si perfaqesuese e drejtperdrejte e Ministrit te Transportit dhe Telekomunikacioneve apo te ngarkuarit e tij, parrezikshmerine dhe sigurine ne transportin ajror dhe aviacionin civil;
- Te kontriboje ne zhvillimin dhe zgjerimin te bashkpunimit dhe operimit te transportit ajror vendas dhe te huaj per tu vene ne sherbim te proceseve te zhvillimit politik, ekonomik, dhe transportit publik ajror te vendit tone nepermjet marreveshjeve te Sherbimit Ajror me vendet e tjera , kontrollin e respektimit te tyre nga operatoret (kompanit ajrore) si dhe miratimin e programeve te skeduluara te kompanive ajrore qe operojne ne vendin tone duke harmonizuar interesat e publikut vendas ,te huaj dhe kapaciteteve te infrastruktures mbeshtetese te aviacionit civil.
- Te kontriboje, percjelle dhe evidentoje programet e zhvillimit te miratuara nga Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacioneve nepermjet perfshirjes ne ne grupet e punes dhe te dokumentoje dhe ndjeke vazhdueshmerine e implementimit te programeve te zhvillimit duke informuar Ministrin e Transporteve e Telekomunikacioneve apo te ngarkuarin prej tij.
- Te drejtoje studimet dhe zbatimet ne praktike te detyrimeve per mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e ambientit dhe zhurmat, ne bashkpunim me strukturat shteterore perkatese dhe operuesit ne fushen e aviacionit civil;
- Te drejtoje dhe te bashkrendoje studimet dhe aktivitetin per zhvillimin e trafikut te brendshem ajror dhe venien ne eficence te aerodromeve dhe fushave lokale te uljes ;
- Te ndjeke detyrat ministrore ne investimet themelore ne Aviacionin Civil Shqiptar, te kontriboje ne zhvillimin ekonomik dhe financiar te ndermarjeve apo institucioneve te aviacionit civil nepermjet kalkulimit te kostove e tarifave te licencimeve, tarifave navigacionale dhe tarifave aeroportuale,

duke kordinuar me institucionet perkatese te aprovuara nga Ministri i Transporteve dhe Telekomunikacioneve apo i ngarkuari prej tij.

- Perpunon ne bashkpunim me struktura te tjera te Ministrise dhe te Aviacionit Civil procedurat e aderimit ne:
  - Traktatin multilateral per Zonen e Bashkuar Europiane te Aviacionit (ECAA) ;
  - Konventen e Sigurise se Aviacionit European (EASA) .
- Siguron (nepermjet aktiviteve te kontrollit) qe personat e certifikuar dhe strukturat e aviacionit jane kompetente dhe operojne ne perputhje me rregullat dhe standartet sipas urdhrave dhe legjislacionit ne fuqi.
- Analizon informacionet e grumbulluara ne lidhje me incidentet , aksidentet dhe situatat e emergjences nga burimet nderkombetare dhe kombetare (strukturat e aviacionit civil ) duke informuar Ministrin e Transporteve e Telekomunikacioneve dhe rekomanduar permirsimet e nevojshme mbi baze te konkluzioneve te komisioneve te investigimit kombetar apo nderkombetar.
- Kontrollon dokumentacionin per leshimin e Autorizimit per ushtrimin e aktivitetit ne fushen e Aviacionit Civil ne zbatim te detyres se Ministrit te Transportit dhe Telekomunikacionit per kete qellim, ushtron funksionet kontrolluese per rastet e revokimit te licencave ne fushen e Aviacionit Civil nga Ministri.

#### **IV.6 Misioni i Drejtorise Transportit Detar**

Sektori i Transportit Detar është njësia më e lartë e administratës detare, portuale dhe ujore e përfshirë në strukturën organizative të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe që varet nga Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, në lidhje me të gjitha çështjet administrative, juridike, ekonomike, financiare, teknike, sociale etj. brenda kuadrit ligjor të kompetencave të kësaj Ministrie.

Sektori i Transportit Detar për realizimin e detyrave të tij bashkëpunon me Drejtoritë e tjera në Ministri sipas problemeve që lindin dhe kompetencave të saj dhe drejtorive të tjera.

1. Përcakton strategjinë e zhvillimit të Transportit Detar, Ujor, dhe Porteve. Mbi këtë bazë përcakton politikat për zhvillimin e transportit detar, ujor dhe porteve.
2. Përcakton rregullat e administrimit të pronës brenda territoreve të porteve dhe të gjithë ndërtimeve publike në porte dhe radat e republikës së

- Shqipërisë duke përfshirë dhe thellimin e kanaleve të lundrueshëm të porteve si dhe rrugëve të tjera detare.
3. Drejton veprimtarinë studimore për përcaktimin e drejtimeve kryesore nëpërmjet kryerjes së studimeve për periudha afat shkurtër, mesme dhe afat gjatë.
  4. Merr pjesë për përgatitjen e legjislacionit për rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin normal të aktiviteteve në fushën e transportit detar, ujqor dhe porteve.
  5. Përcakton rregullat dhe udhëzime për transportin e mallrave dhe udhëtarve me det.
  6. Nxjerr rregulla dhe udhëzime për regjistrimin e anijeve dhe liçensimin e tyre si dhe klasifikimin e tyre.
  7. Përcakton rregullat që kanë të bëjnë me sigurinë detare duke përfshirë sigurinë e anijeve detare dhe atyre të peshkimit si dhe mënyrën e inspektimit të tyre.
  8. Përfaqëson Republikën e Shqipërisë në të gjitha forumet detare ndërkombëtare.
  9. Mbi bazën e Konventave ndërkombëtare përgatit legjislacionin përkatës për rregullat e lundrimit detar, pilotimit dhe rimorkimit brënda ujërave të Republikës së Shqipërisë.
  10. Ne bashkepunim me Drejtorinë e maredhenieve me Jashtë përgatit dhe realizon marreveshjet e bashkepunimit ne fushen e detarise.
  11. Bashkepunon me Institucionet perkatese dhe jep mendime per hatimin dhe realizimin e projekteve e ndryshme ne fushen e turizmit, peshkimit, mbrojtjes se mjedisit etj.
  12. Merr pjese, duke bashkepunuar me drejtorite e tjera, ne lidhje me kryerjen e investimeve ne sektorin e transportit detar, ujqor dhe porteve.

Mbi bazën e detyrave të përcaktuara në nenin 3 në kompetencë të saj për sa i lejon ligji janë:

1. Aktiviteti i të gjithë strukturave në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë dhe gjithë infrastrukturave portuale gjatë bregdetit dhe territorit të Republikës së Shqipërisë për të cilën shteti ka kryer investime për qëllime komerciale.
2. Aktiviteti i transportit detar nga ana e subjekteve private.
3. Aktiviteti i Institucionit të Kapitenerisë së Porteve
4. Aktiviteti i Regjistrimit Detar Shqiptar
5. Aktiviteti Anijeve të Shërbimeve Detare
6. Aktiviteti i Ndërmarrjes së Kontrollit të Mjeteve Ujqore
7. Agjencisë Detare Shtetërore "TAULANTIA"
8. Instituti i Studimeve të Transportit për pjesën që ka të bëjë me lidhjet dhe projektet e ndryshme në fushën e detarise.
9. Bordet e ndërmarrjeve të përbashkëta ku pjesa e kapitalit është shtetëror.

#### **IV.7 Misioni i Drejtorise Integritit dhe marredhenieve me Jashte**

Drejtoria e Integritit dhe Marredhenieve me Jashte, ne kuader te Marreveshjes se Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian, objektiv kryesor te saj ka perafrimin dhe integrimin e legjislacionit Shqiptar me ate Europian ne fushen e Transportit dhe Telekomunikacionit. Ky objektiv konkretizohet nepermjet Marreveshjeve Bilaterale, Memorandumeve te posacme te Bashkepunimit, aderimit ne Konventat Europiane dhe Nderkombetare, pjesemarrja ne iniciativat rajonale SECI dhe BSEC, Konferencen Europiane te Ministrave te Transporteve CEMT, ne Organizaten Nderkombetare te Rrugeve IRU dhe shume organizma te tjere ICAO, ECAC, EUROCONTROL.

Detyrat funksionale te kesaj Drejtorie ne pergjithesi jane mbeshtetja dhe koordinimi i aktivitetit te ketij institucioni me institucionet homologe evropiane dhe me gjere.

- Ndjek gjithë korrespondencat me jashte.
- Mban lidhje permanente me Ambasadat Rezidente ne Shqiperi me informacione te nevojshme si dhe me percjelljen e Notave Verbale.
- Mban kontakte te perhershme me Ministrine e Puneve te Jashtme, administron korrespondencen perkatese dhe pergatit informacionet e nevojshme per takime te rendesishme te ketij institucioni me institucionet homologe.
- Ndjek dhe administron korrespondencen e tre nismave rajonale BSEC, SECI ne te cilat jemi anetare me te drejta te plota.
- Perktimi dhe redaktimi i Marreveshjeve bilaterale ne fushen e transportit ne pergjithesi.
- Ndjek dhe asiston ne pergatitjen e Marreveshjeve Bilaterale ne fushen e Transportit Nderkombetar rrugor, ajror, detar, hekurudhor etj, deri ne ratifikimin e tyre nga Parlamenti Shqiptar.
- Ne bashkepunim me Drejtorite ne Ministri dhe Institutin e Transportit pergatit materialet mbi aderimin e ketij institucioni ne Konventat Nderkombetare te Transportit ne pergjithesi.
- Mban te gjithë korrespondencen me Konferencen e Ministrave te Transporteve te Evropes (ECMT), njekohesisht merr pjese ne mbledhjet plenare periodike te ketij institucioni te rendesishem.

- Pergatit dhe ndjek protokollin e takimeve qe zhvillohen ne Ministrine e Transportit dhe Telekomunikacionit.
- Ndjek ecurine e pasnenshkrimit te Protokolleve.
- Ne bashkepunim me Drejtorite e Ministrise pergatit informacione periodike mbi nivelin e marredhenieve te institucionit me Institucionet homologe ne fushen e Transportit.
- Pergatit programet e punes ne rastin e vizitave te delegacioneve te huaja.
- Shoqeron delegacionet e huaja ne vizitat e ndryshme.
- Merr pjese ne takimet e punes me delegacionet e huaja.
- Menaxhon te gjitha praktiken shkresore deri ne realizimin te shkembimit te Lejeve te Kalimit per transport nderkombetar rrugor te mallrave dhe pasagjereve me vendet me te cilat kemi marreveshje bilaterale
- Ndjek dhe menaxhon praktiken me Organizaten e CEMT per sigurimin e kuotes se lejeve multilaterale.
- Asiston ne bisedimet per parafimin e Marreveshjeve dhe ne pergatitjen e Protokollit.

#### **IV.8 Misioni i Drejtorise Juridike**

Ne bashkepunim me sektoret dhe drejtorite e tjera harton planin vjetor te pergatitjes se projektligjeve,akteve nenligjore dhe udhezimeve, rregullore dhe urdheresa te ministrit.

Studion,harton dhe siglon edhe aktet e nxjerra nga Ministri dhe nga Ministria ne zbatim te akteve te ndryshme ligjore dhe nenligjore.

Studion, pergatit, paraqet per miratim te organeve perkatese,projkakteve ligjore dhe nenligjore qe jane kopetence te Ministrit ,bashkerendon dhe ndihmon Drejtorite per pergatitjen e Projektligjeve,projktvendimeve,projektudhezimeve si dhe konfirmon bazueshmerine ligjore te akteve te nxjerra nga Ministri.

Ndjek dhe bashkerendon ecurine e shqyrtimit te marrjes se vendimeve dhe verejtjeve per projekt aktet ligjore dhe nenligjore te pergatitura nga Ministria me ministrite e tjera dhe ne vecanti me Ministrine e Drejtesise.

Harton dhe pergatit nga pikpamja juridike kontrarat dhe marreveshjet qe lidh Ministria me subjektet per kryerjen e veprimtarise se saj, duke bashkerenduar me Drejtorine dhe sektoret e tjere te Ministrise.

Ndjek proceduren dhe ecurine e shqyrtimit te Projekteve me departamentin juridik ne Keshillin e Ministrave dhe sipas rastit me kuvendin.

Ndjek,pergatit dhe perfaqeson ne organet gjygesore ceshtjen qe lidh me veprimtarine e Ministrise,duke bashkerenduar me Drejtorite perkatese.

Ndjek dhe bashkerendon punen me drejtorite e tjera per pergatitjen e mendimeve per projektet ligjore dhe nenligjore te paraqitura nga Mnistri ose institucionet e tjera qendrore.

Bashkerendon punen me Ministrine e Drejtesise per ceshtjet e pergjithshme te Legjislacionit.

Drejton punen e njohjes se legjislacionit te ri me punonjesit dhe specialistet e ministrise

Shqyrton ankesat drejtuar ministrit per procedurat e tenderimit dhe shpronesimit te zhvilluara nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe drejtorite ne vartesi te saj duke pergatitur pergjigjet perkatese.

Jep sqarime,keshilla, asistence dhe te tjera enteve prokurorese qe realizojne procedura prokurime me fonde te buxhetit te vena ne dispozicion nga Ministria.

Ben propozime dhe sygjerime konkrete per ndryshim dhe plotesim te ligjit dhe akteve nenligjore ,kryesisht ne fushat te cilat lidhen me veprimtarine e Ministrise se Transportit dhe Telekomunikacionit.

Mban lidhje midis Ministrise dhe Agjensise se Prokurimeve Publike per te gjithe problemet qe lidhen me Prokurimet.

Merr pjese ne komisionin e posacem te shpronesimeve.

#### **IV.9 Misioni i Drejtorise se Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve**

- Harton politiken e burimeve njerezore te institucioneve te deges se transportitdhe telekomunikacionit, kualifikimit dhe specializimit afatshkurter dhe afatmesem te punonjesve ne Ministri dhe te hallkave te varesise ne bashkepunim me drejtorite e tjera te Ministrise.

- Shqyrton, analizon dhe ndjek kriteret e pranimit te specialisteve ne aparatit e Ministrise, ne perputhje me kerkesat e misionit te secilit vend pune, lloji i specialitetit, eksperiences dhe vjetersise ne pune, niveli i arsimimit etj ne perputhje me kriteret e ligjit dhe te akteve nenligjore per statusin e nepunesit civil.

- Ndjek programet dhe miraton propozimet per pergatitjen e kualifikimin e specialisteve te transportit brenda dhe jashte vendit.

- Evidenton te dhena per vijueshmerine dhe ecurine e personelit qe jane ne varesi te ketij dikasteri si dhe probleme te tjera studimore e administrative.
- Planifikon dhe detajon numrin e punonjesve te miratuar per cdo institucion buxhetor si dhe ndjek cdo tremujor zbatimin e tij.
- Ne bashkepunim me Ministrine e Punes dhe Çeshtjeve Sociale, miraton renditjen e detyrave sipas klasave per institucionet buxhetore si dhe ndjek zbatimin e tyre ne praktike.
- Ne bashkepunim me Ministrine e Shendetesise miraton shitesat ne page per pune te veshtira dhe te demshme per shendetin.
- Harton projektvendime ne fushen e pagave.
- Ndjek dhe merr masa per zbatimin e politikës per pagat e punes te instucioneve buxhetore.
- Kryen studime per pagat dhe shitesat e ndryshme mbi pagat sipas kerkeses se DAP dhe Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale.
- Mban lidhje te vazhdueshme dhe raportime mujore me DAP mbi vendet e lira, emerimet shpenzimet e konkurimeve etj.
- Ne kuadrin e sherbimeve dhe bashkepunimit tekniko-profesional, pergatit dokumentacionin e nevojshem per dergimin e grupeve jashte shtetit.
- Organizon, bashkerendon punen per permiresimin e rregullores se brendshme te Ministrise dhe te rregulloreve analitike te drejtorive.
- Pergatit, ndjek e verifikon rregullat e pergjithshme te veprimtarise se punonjesve te Ministrise, te sherbimit dhe te mirembajtjes se objektit, te kriterëve per zbatimin e disipline ne pune.
- Ben pranimin, evidentimin, shperndarjen ne aparat dhe nisjen e korrespondences zyrtare si dhe arshivimin e kesaj korrespondence.
- Drejton punen e bibliotekes dhe informacionin e arkivimit ne lidhje me aktivitetin qe mbulon ky dikaster duke ja bere te njohur arshives.
- Organizon dhe kryen sherbimin e aparatit per redaktimin e drejtshkrimin e te gjitha materialeve qe pergatisin drejtorite me destinacion ne organet e larte shtetore e institucione te ndryshme.
- Ben planifikimin e fondeve per shpenzimet buxhetore te aparatit te Ministrise dhe ne baze te planit te buxhetit te miratuar, ndjek dhe evidenton realizimin e tyre ne perputhje me dispozitat ligjore.
- Organizon, ndjek dhe administron sherbimin e autoveturave per te mbuluar nevojat e drejtorive, sektoreve dhe punonjesve.
- Ndjek realizimin e shpenzimeve dhe organizon riparimin e automjeteve.
- Organizon dhe kryen furnizimin materialo-teknik te aparatit te Ministrise.
- Mbulon sektorin e llogarise se aparatit te Ministrise i cili mban kontabilitetin dhe kryen administrimin e pasurise dhe fondeve buxhetore te planifikuara. Evidenton veprimet financiare dhe te pagesave, pergatit dhe nxjerr balance periodike e vjetore financiare te aparatit te Ministrise.
- Bashkerendon punen dhe kryen lidhjen e Ministrise me Departamentin e Administrates Publike ne Aparatin e Keshillit te Ministrave dhe me Ministrine e Punes dhe Ceshtjeve Sociale, si dhe me te gjitha drejtorite e pergjithshme e institucioneve te tjera ne varesi te Ministrise per ceshtjet e personelit, kualifikimit e specializimit te kontigjentit te punonjesve publike dhe te pagave.

#### **IV.10 Misioni i Drejtorise Drejtorise se Pergjithshme te Poste Telekomunikacionit**

Drejtoria e Pergjithshme e Poste-Telekomunikacioneve (DPPT) e ushtron aktivitetin e saj konform dispozitave te ligjit nr. 8618, date 14.6.2000 "Per telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise" dhe te ligjit nr. 8530, date 23.9.1999 "Per sherbimet postare ne Republiken e Shqiperise".

Bazuar ne percaktimet e dy ligjeve te permendura me siper, detyrat e Drejtorise se Pergjithshme te Poste-Telekomunikacioneve konsistojne si me poshte.

##### **Ne sektorin e telekomunikacioneve dhe teknologjise se informacionit**

1. Harton dhe propozon politikat e zhvillimit te telekomunikacioneve;
2. Harton dhe propozon akte ligjore e nenligjore per zhvillimin e sektorit te telekomunikacioneve;
3. Harton politikat e perdorimit te spektrit re radiofrekuencave;
4. Harton dhe propozon per miratim Planin Kombetar te Radiofrekuencave dhe punon per harmonizimin e tij me politikat nderkombetare te zhvillimit te spektrit te radiofrekuencave. Ndjek zbatimin e detyrave qe lindin nga Plani Kombetar i Radiofrekuencave ndaj institucioneve te ngarkuara per administrimin e spektrit.
5. Ben oponente propozimeve te ardhura nga ERT per aktet ligjore ne lidhje me: a) kriteret dhe kushtet e dhenies se licencave per ofrimin e sherbimeve telefonike kombetare fikse dhe celulare si dhe procedurat e zhvillimit te tenderit, b) metodologjine e kontrollit te tarifave te sherbimeve te ofruara nga nje organizem me fuqi te ndjeshme ne treg; si dhe ben propozimet perkatese;
6. Mer pjese ne hartimin e politikave kombetare per zhvillimin e teknologjise se informacionit dhe ne zbatimin e planeve te veprimit, qe do te per pmbushjen e objektivave te ketyre politikave.
7. Shqyrton ankesat e operatoreve te telekomunikacioneve ne lidhje me vendimet e ERT per ndryshimin, pezullimin dhe heqjen e licences dhe i propozon Ministrit marrjen e vendimit perkates.
8. Harton dhe i propozon Ministrit nxjerrjen e udhezimeve, ne zbatim te nenit 57 te ligjit nr. 8618.
9. Koordinon ne shkalle kombetare dhe nderkombetare veprimtarine e radionderlidhjes bregdetare.
10. Mbeshtet veprimtarine e radioamatorizimit.
11. Studion menytrat qe duhen ndjekur per arritjen e objektivave te sherbimit universal dhe ben rekomandimet perkatese.
12. Ne kuadrin e angazhimit per asocim ne Bashkim European, studion direktivat e KE per telekomunikacionet dhe rekomandon implementimin e tyre nepermjet rugeve ligjore.
13. Studion politikat globale te telekomunikacioneve dhe rekomandon implementimin e tyre.

14. Mbledh dhe perpunon te dhenat nga operatoret publike te telekomunikacioneve dhe pergatit studime mbi gjendjen e telekomunikacioneve si dhe prognoza per te ardhmen.

15. Bashkerendon punen me Ministrine e Mbrojtjes, Ministrine e Rendit dhe SHISH per zbatimin e detyrave qe lidhen me ceshtje te perbashketa, si dhe ato qe lidhen me parashikimet e ligjeve nr. 8618 dhe nr. 8530 per sigurimin kombetar.

16. Bashkerendon aktivitetet me karakter nderkombetar si dhe bashkepunon me administratat e huaja te telekomunikacioneve. Ndjek zbatimin e detyrimeve per sektorin e telekomunikacioneve qe rrjedhin nga marreveshjet, konventat e protokollat dy paleshe dhe/ose shumpaleshe, ne te cilat aderon Republika e Shqiperise.

### **Ne sektorin e postave**

1. Harton dhe propozon akte ligjore e neligjore per zhvillimin dhe rregullimin e veprimtarise ne sektorin postar.

2. Harton dhe propozon politikat per nxitjen e investimeve ne sektorin postar dhe zhvillimin e sherbimeve postare.

3. I propozon per miratim Ministrit normativat dhe treguesit cilesore te sherbimeve postare dhe siguron nepermjet standardizimit, rregulloreve teknike, veprimtarive kerkimore dhe rekomandimeve nderkombetare permiresimin e tyre.

4. I propozon Ministrit dhenien e licencave dhe lejeve per ofrimin e sherbimit postar, si dhe ndjek zbatimin e kerkesave te ligjit nr. 8530.

5. Studion politikat globale te postave dhe rekomandon implementimin e tyre;

6. Ne kuadrin e angazhimit per asocim ne Bashkim European, studion direktivat e KE per sektorin postar dhe rekomandon implementimin e tyre nepermjet rrugeve ligjore;

7. Harton planet kombetare te trajnimit te burimeve njerezore ne sektorin postar.

8. Ndjek zhvillimin e tregut postar dhe kushtet e ofrimit te sherbimit baze, dhe mbeshtetur ne to rishikon madhesine e zones se rezervuar dhe propozon respektivisht masat per kufizimin e saj gradual dhe te kontrolluar ne te ardhmen.

9. I propozon Ministrit masat per zbatimin e kerkesave te parashikuara ne nenin 15 te ligjit nr. 8530.

10. Ushtron kontroll mbi veprimtarine e operatorit publik postar per plotesimin e kushteve te marreveshjes se lidhur per sigurimin e sherbimit baze.

11. Harton tarifat per sherbimet baze dhe sherbimet e rezervuara qe ofron operatori publik postar dhe i propozon Ministrit miratimin e tyre nga Keshilli i Ministrave.

12. Mbledh nga operatoret e sherbimit postar çdo informacion te nevojshem per ushtrimin e funksioneve te veta dhe publikon ato informacione qe lidhen me ecurine e pergjitheshme te postave ne Republiken e Shqiperise.

13. Bashkerendon aktivitetet me karakter nderkombetar si dhe bashkepunon me administratat e huaja te postave. Ndjek zbatimin e detyrimeve

per sektorin e postave qe rrjedhin nga marreveshjet, konventat e protokollet dy paleshe dhe/ose shumpaleshe, ne te cilat aderon Republika e Shqiperise.

14. Asiston Komisionin Shteteror te Pulles dhe ndjek zbatimin e detyrave te ngarkuara prej tij, i cili me VKM nr. 405, date 27.7.2000 funksionon prane DPPT.

#### **IV.11 Misioni i Drejtorise se Pergjithshme te Programimit**

-Shqyrton, bashkerendon ceshtjet thelbesore te planifikimit ekonomik, afatmesem dhe strategjik ne shkalle transporti, bazuar ne projekt programet e drejtorive per secilin sektor te transportit e mbeshtetur ne burimet financiare te Buxhetit te Shtetit dhe te financimeve te huaja.

- Percakton, drejton dhe udheheq metodologjine e planifikimit te sistemeve dhe te treguesve te saj tekniko – ekonomike, te zhvillimit te transportit dhe telekomunikacionit ne shkalle vendi, ne zonat ( rajonet ) e korridorret tranzite.

- Ndjek ne bashkepunim me drejtorite e tjera, fenomenet dhe pritjet e ecurise se proçeseve te zhvillimit te transportit, si dhe nxjerr konkluzonet per percaktimin formulimin e sintezimin e politikave te pergjithshme te zhvillimit te transportit dhe telekomunikacionit nepermjet kordinimit me drejtorite sektoriale.

- Propozon, mbi bazen e struktures ekonomike te sektoreve te transportit dhe telekomunikacionit efektivitetit ekonomik dhe te strategjive te zhvillimit te tyre, prioritetet sektoriale ne raport te paketave te pergjithshme financiare.

- Bashkerendon me drejtorite sektoriale, mbi bazen e shyrtimeve te projekt planeve vjetore te njesive shteterore te varesise se tyre, per grumbullimin e treguesve tekniko – ekonomike e financiare, per hartimin e projekt programeve makro – ekonomike te sektoreve te transportit dhe telekomunikacionit.

- Organizon, drejton, ndjek dhe jep udhezime metodologjike per hartimin e projekt buxhetit nga njesite e varesise te Ministrise. Shqyrton, pergatit dhe paraqet per miratim projekt buxhetin e ministrise dhe mbas miratimit te tij ben detajimin sipas istitucioneve dhe njesive te shkalle vjetore dhe ne 4 mujore. Kryen ndryshimet e nevojshme ne buxhetin sipas kompetencave dhe ndjek realizimin e tij gjate vitit.

- Organizon, kryen dhe ndjek planifikimin vjetor dhe detajimin periodik te fondeve te investimeve me buxhetin dhe financimin e huaj per rehabilitimin e infrastruktures se rretit rrugor, hekurudhor, te porteve e aeroportive dhe te mjeteve e objekteve te tjere te transportit dhe telekomunikacionit.

- Organizon, drejton dhe bashkerendon planifikimin vjetor dhe me afat me te gjere te nevojave te fondeve per koston lokale Tvsh + Taksa Doganore etj, te investimeve me financim te huaj ne te gjitha llojet e transportit.

- Organizon, drejton dhe ndjek sherbimin statistikor ne transport dhe telekomunikacionit Programim Kombetar Statistikor dhe te kerkeseve te organizatave nderkombetare te transportit dhe telekomunikacionit.

- Monitoron dhe kordinon aktivitetin qe lidhet ne fazat e ciklit te pergatitjes se projekteve, duke filluar nga identifikimi, formulimi e deri ne monitorimin dhe vleresimin e projekteve te transportit dhe telekomunikacionit.

- Siguron, kordinimin perkates midis drejtorive ne Ministri dhe agjensive ekzekutive nga njera ane dhe agjensive te donatoreve te huaj nga ana tjetere per zbatimin me eficience te projekteve sektoriale, ne perputhje me ligjet dhe rregullat e vendit dhe me kerkesat financiare dhe teknike te donatoreve.
- Bashkerendon me Ministrine e Ekonomise per percaktimin e procedurave te monitorimit dhe vleresimit per te mundesuar rregullat e vendit dhe me kerkesat financiare dhe teknike te donatoreve.
- Asiston ne drejtorite perkatese dhe njesite e drejtimit te projekteve dhe agjencite ekzekutive ne identifikimin dhe formulimin e projekteve ne vazhdim te projektit ne te ardhmen.
- Asiston ne drejtorite perkatese dhe njesite e drejtimit te projekteve dhe agjencite ekzekutive ne identifikimin dhe formulimin e projekteve te reja, vleresimin e projekt propozimeve per t'ua bere prezent organeve kompetente.
- Nderton sistemin e informimit te projektit nepermjet te cilit informacioni mund te gjendet ne cdo kohe dhe ne menyre te qendrueshme.
- Ben vleresimin e pergjithshem te projekteve me rezultat perfundimtare.
- Ben perpunimin periodik dhe analizen e te dhenave statistikore dhe njofton per ecurine e zbatimit te te dhenave te programit ekonomik ne hallkat e transportit dhe telekomunikacionit.
- Jep mendime dhe I propozon organit emertues, ndertimin dhe persosjen e sherbimit statistikor te vendeve te tjera te Evropes.
- Organizon, drejton dhe bashkerendon problemet financiare e te kontabilitetit te deges se transportit dhe telekomunikacionit.
- Organizon evidencen e realizimit te treguesve te buxhetit, ben rakordimin dhe ja dergon ate organeve kompetente.
- Ndjek mbylljen e bilanceve te institucioneve buxhetore te varesise I shqyrton ato, harton dhe paraqet Ministrise se Financave bilancin permblendes.
- Drejton, ndjek dhe ben udheheqjen metodologjike te sistemit te kontabilitetit, sistemit fiskal, harton tarifat dhe cmimet e transportit dhe telekomunikacionit si dhe te sherbimeve aeroportuale te kontrolluara nga shteti, ne bashkepunim me drejtorite perkatese dhe I paraqet ato per miratim.
- Bashkerendon punen dhe kryen lidhjen e Ministrise se Financave, Ministrise e Ekonomise, INSTAT si dhe me organet perkatese ne drejtorite e pergjithshme dhe njesite e tjera te varesise te Ministrise.
- Njesite e monitorimit dhe vleresimit e mbeshtesin punen e tyre ne vendimet e marra nga Grupi teknik Sektorial I Ministrise perkatese. Keto njesi monitorojne dhe kryejne vleresime per politikat e ndjekura dhe bejne propozime per nderhyrje dhe ndryshime.
- Krijimi dhe mirembajtja e nje sistemi per monitorimin dhe vleresimin e SKZHES, duke perfshire zhvillimin e treguesve te monitorueshem te pershtatshem dhe vazhdimi I permiresimit dhe zgjerimit te numrit te tyre.
- Zhvillimi I sistemit te mbledhjes se informacionit per treguesit dhe percaktimi I pergjegjesive te qarta. Krijimi I nje mekanizmi per shkembimin e informacionit reciprok te kerkuar per indikatore te veçanteme Ministrite e linjes (ne njesite e monitorimit dhe vleresimit)

- Bashkepunimi, mirekuptimi dhe koordinimi ne Ministri dhe me ekspertet mbi zhvillimin e indikatoreve te pershtatshem si dhe per te realizuar analiza te politikave ne kuadrin e strategjise dhe te shpenzimeve ne kuadrin e programit te Buxhetit Afatmesem qe rrjedhin nga monitorimi dhe vleresimi i te dhenave. Ne kete kuader ajo vlereson indikatorët per vitin baze dhe parashikon e propozon vlerat etyre per vitet ne vazhdim.
- Sigurimi I bashkepunimit me Ministrine e Financave, ne veçanti me Sekretariatit Teknik te SKZHES per te percjelle ne kohen e duhur informacionet perkatese per te pergatitur analizat dhe raportet e progresit.
- Koordinimi I punes me derejtorite ne Ministri dhe institucione te tjera per zbatimin e masave te matricave te SKZHES.
- Nxitja e perdorimit me te gjere e rezultateve nga Monitorimi dhe vleresimine hartimin e politikave dhe te programimit brenda Ministrise.

#### **IV.13 Misioni i Drejtorise Kontrollit Financiar**

**I. Objekti i veprimtarise :** Te ushtroje kontroll te pergjithshem ne objektet e vartese, duke garantuar se veprimtaria e subjekteve eshte ne perputhje me kerkesat e rregullat, se subjektet ruajne burimet e buxhetit, te kapitalit shteteror etj ne nje menyre te tille qe nxit operacionet ekonomike ne menyre te fryteshme dhe me rezultat, se te dhenat financiare dhe te drejtimit te subjektit jane te sakta dhe te plota.

Perpunon, analizon dhe dergon konkluzionet e kontrollit ne objektet e kontrolluara

Pergatit materiale dhe njofton Ministrin per shkeljet dhe abuzimet e vertetuara ne drejtim te ligjshmerise financiare .Organizon punen per perpunimin e te dhenave nga zbulimet e kontrollit per sistemin e transportit dhe telekomunikacionit, cdo 3 mujor me evidenca dhe raporte permbledhese duke raportuar ne Ministrine e Financave,

Kryen verifikime dhe zgjidh probleme te ndryshme qe dalin ose ngrihen nga letrat dhe informacionet e ndryshme qe vijne ne Ministri, ne fushen ekonomiko financiare.

#### **IV -14 Drejtoria e Inspektimit dhe Monitorimit te Punimeve**

-Harton politiken e pergjithshme te investimeve ne llojet e ndryshme te infrastrukturave te transportit dhe ndjek ne vijueshmeri zbatimin e saj ne hallkat ne varesi te Ministrise.

- Organizon, kryen dhe ndjek planifikimin vjetor, detajimin periodik te fondeve te investimeve te buxhetit, ndryshimet apo rialokimet gjate vitit dhe bashkerendon planifikimin vjetor e me afat me te gjere te nevojave te fondeve per Koston Lokale, TVSH, te investimeve me financim te huaj ne te gjithe infrastrukturen e transportit.

- Organizon dhe grumbullon projektprogramet vjetore te njesive shteterore ne varesi te Ministrise per hartimin e projektprogramit te investimeve buxhetore te infrastruktures se transportit.
- Kontribuon ne saktesine e programit te investimeve buxhetore te realizimit te tij, te grafikut te kryerjes se punimeve te dokumentacionit te kontratave, si dhe ne gjykimin e punes se investitoreve, te enteve prokuruese e te sipermarresve.
- Bashkerendon punen e Ministrise me Drejtorine e Pergjithshme te Rrugeve, organeve respektive te hekurudhes, porteve, aeroportive dhe te gjitha njesive te varesise per problemet e investimeve buxhetore.
- Shqyrton, verifikon dhe jep mendime per mbikqyrjen vizuale objekteve ndertimore ne infrastrukturen e transportit. Bashkerendon punen me njesite ne varesi te Ministrise per permiresimin e kushteve te kontratave te ndertimit, te mbikqyrjes dhe te kolaudimit te objekteve.
- Ne bashkerendimin me njesite e varesise se Ministrise ndjek lidhjen e kontratave, derdhjen e garancise se kontrates, ecurine dhe perfundimin e objekteve brenda afateve te percaktuara ne dokumentet e tenderit te miratuar nga Titullari i Ministrise.
- Shqyrton verifikon dhe jep mendime per reputacionin, aftesite teknike dhe teknologjike, njerezore dhe intelektuale te firmave ndertuese dhe projektuese qe marrin pjese ne konkurim per projektimin dhe ndertimin e objekteve te infrastruktures se transportit.
- Bashkerendon punen per çeshtjet e teknologjise se ndertimit, standarteve teknike , te cilesiese se materialeve te ndertimit dhe te reputacionit te shoqerive te ndertimit.
- Shqyrton dhe jep mendime per projektet teknike te objekteve te investimeve kombetare dhe ben vleresimin e varesive me optimale.
- Verifikon e shqyrton hartimin e grafikeve vjetore te objekteve te rendesishem dhe ndihmon ne permiresimin e tyre duke i perputhur me mundesite reale teknike, njerezore e financiare.
- Organizon takime e konsulta per probleme te veçanta e te rendesishme per harmonizimin e te gjitha vepimtarise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- Bashkerendon me drejtorite e Ministrise ne pergatitjen e mendimeve per projektet e akteve ligjore e nenligjore te paraqitura nga Ministrite dhe institucionet e tjera si dhe per hartimin dhe pergatitjen nga ana teknike te projekteve ne kompetence te Ministrise.
- Ndjek punen per realizimin e shpronesimeve te objekteve ne kohe dhe propozon masen ndeshkimore e nderhyrjen nga titullari.

#### **IV.15 Njesia e Menaxhimit te Projekteve PHARE**

PMU ose Njësia e Menaxhimit të Projekteve e akomoduar pranë Ministrisë të Transportit dhe Telekomunikacionit është struktura e cila asiston PAO (Program Authorising Officer) në implementimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të Programeve Phare për transportin dhe pikat kufitare. Programet Phare janë fonde grant nga Komuniteti European për zhvillimin e infrastruktures së

Shqiperisë me qëllim integrimin e saj në bashkësinë europiane. Në këtë kontekst funksionet primare të PMU janë:

- të planifikojë fondet e duhura për implementimin e projekteve të përfshira në Programet PHARE me anën e Programeve të punës 6 mujore.

- të përgatisë dhe ndjekë të gjithë procesin e prokurimit të fondeve në përputhje me procedurat e PHARE.

- të monitorojë dhe të menaxhojë disbursimet e fondeve PHARE në lidhje me implementimin e projekteve.

- të sigurojë raportet e nevojshme për PAO, EC , Delegacionin e EC dhe çdo Ministri apo organizate tjetër që ka lidhje me Programin.

- koordinimi i menaxhimit të fondeve, kontabilizimit, raportimit dhe planifikimit të tyre.

- të sigurojë zbatimin e konditave të kontratës, në lidhje me implementimin e punimeve dhe të supervizionit të tyre sipas standarteve PHARE

Për të realizuar këto objektiva kjo drejtori ka në strukturë tre departamente ;

1. **Asistenca teknike** e përbërë nga dy specialistë e cila punon në aspektet e menaxhimit të kontratave dhe problemeve tekniko-financiare me firmat ndërtuese dhe supervizuese ;
2. **Planifikimi dhe financa** që mbulon realizimin e Programeve të punës kontabilizimin e raportimin financiar ;
3. **Inxhinjerët e projekteve** të cilët ndjekin detajet në të gjitha fazat e implementimit të projekteve specifike.

#### **IV. 16 Njesite e zbatimit të projekteve.**

Per administrimin e programeve të financimeve të huaja të Komunitetit Europian, të Institucioneve Financiare Nderkombetare, të kredive.. të shteteve të ndryshme, Ministria në bashkëpunim me autoritetet përfaqësuese sipas qëllimit të tyre krijon strukturat e varesise të saj apo me kontraktim njesi të veçanta për drejtimin dhe administrimin e projekteve deri në përfundim të tyre. Detyrat e veçanta përcaktohen në kontratën respektive.

#### *V. Detyrat e përgjithshme dhe kompetencat e nepunesve sipas klasifikimit.*

##### **1. Drejtoret e Drejtorive dhe të Njesive.**

- Përgjigjen për zbatimin e detyrave kryesore që përmban rregullorja e Ministrise si dhe të detyrave analitike që përmban rregullorja e drejtorise.

- Në bashkëpunim me sektorët , zyrat dhe specialistet hartojnë programet vjetore, planet e masave tekniko-organizative, tematika të ndryshme dhe programet e veçanta për të gjithë drejtorite.

- Ndjekin zbatimin e të gjithë programeve të punës të drejtorise dhe specialisteve.

- Drejtore takime pune te ndryshme me perfaqesues te institucioneve te ndryshme per çeshtjet e misionit dhe te kompetencave te drejtorive.
- Bejne analiza periodike e vjetore te drejtorise dhe per probleme te veçanta.
- Bashkerendon punen me drejtori te tjera ne Ministri per çeshtje e probleme te karakterit te perbashket e koordinativ.
- Ndjek problemet e kualifikimit dhe te vleresimit te punes te punonjesve te drejtorise.
- Perpilon raporte, njoftime e informacione per analizat e ndryshme sipas materialeve qe pergatisin specialistet e drejtorise dhe te dhenave te drejtorive te tjera ne perputhje me detyrat qe mbulon drejtoria.
- Organizon punen studimore ne shkalle drejtorie dhe ne bashkepunim me drejtorite e tjera ne Ministri, si dhe me dikasteret e institucionet e tjera per studime te perbashketa dhe te permiresimit te legjislacionit ne fushat perkatese.
- Organizon studime e konsulta me punonjesit e varesise dhe te sektoreve te transportit per persosjen e metejshme te funksioneve te drejtorise.
- Therret ne raport sipas problemeve drejtuesit e hallkave te ndryshme te transportit ose punonjesit e varesise per problemet qe mbulon drejtoria.
- Nenshkruan te gjitha aktet zyrtare, njoftimet, informacionet etj. qe dalin nga drejtoria dhe siglon te gjitha aktet qe duhet te nenshkruhen nga Ministri.

## **2. Pergjegjesi i Sektorit**

- Eshte pergjegjes per drejtimin e sektorit.
- Raporton per progresin e aktivitetit te sektorit dhe realizimin e detyrave perpara drejtorit te drejtorise.
- Trajton problemet aktuale dhe te perspektives qe lidhen me detyrat e sektorit.
- Merr pjese ne hartimin e akteve nenligjore, rregulloreve, udhezimeve etj. qe burojne nga legjislacioni ne zbatim te veprimtarise se sektorit.
- Ben propozim per ndryshime ne legjislacionin perkates diktuar nga procesi i zhvillimit dhe vrojtimit te aktiviteteve ne praktike.
- Ben kontroll e ndjek punen e specialisteve ne vijueshmeri e sipas detyrave te çdo specialisti.
- Pergjegjesi i sektorit krahas drejtimin te punes se specialisteve te sektorit, mund te mbuloje edhe nje pjese te detyrave te specialistit te percaktuar ne rregulloret e drejtorise.
- Ben propozime per pjesemarrjen e specialisteve ne grupe te ndryshme qe lidhet me veprimtarine e punes e shkallen e kualifikimit.
- I propozon e i sugjeron drejtorit per kriteret e pranimin dhe te perzgjedhjes se specialisteve te sektorit.
- Propozon drejtorite per pjesemarrjen e specialisteve ne kurse dhe seminare kualifikimi apo perfaqesimi per çeshtjet qe ndjek e mbulon specialisti.
- Siglon te gjitha materialet qe pergatiten nga specialistet e sektorit , qe i paraqet drejtorit, i cili nenshkruan.
- Ben vleresimin paraprak te punes se specialisteve te sektorit.

-Pergjegjesi i sektorit krahas drejtimin te punes se specialisteve te sektorit mund te mbuloje edhe nje pjese te detyrave te specialistit te percaktuar ne rregulloret e drejtorise.

### **3. Specialisti ne Ministri**

-Punon per zbatimin e detyrave te misionit te tij te percaktuar ne rregulloren e Ministrise, ne rregulloren analitike te drejtorise dhe ne misionin e detajuar te sektorit.

-Punon ne perputhje me shkallen e kualifikimit dhe te kerkesave te vendit te punes .

-Te kryeje punen me cilesi, saktesi dhe ne afatet e caktuara.

-Te ndjeke dhe te zbatoje ne detaje legjislacionin gjate kryerjes se detyres ne nivelin e punes.

-Te vetveproje me kompetence ne zbatimin e detyres se tij, duke bashkrenduar me specialistet e tjere brenda drejtorise dhe me specialistet e tjere te drejtorive te tjera brenda Ministrise, dhe te kontrolloje e te ndjeke detyra me sektoret e varesise ne hallkat ne varesi te Ministrise.

-Te pergatise materiale te ndryshme ne lidhje me veprimtarine e vendit te punes dhe ti konceptoje me nivel e cilesi ato.

#### ***Dispozitat e fundit.***

Ne rregulloret e drejtorive detyrat e drejtoreve, pergjegjsave te sektoreve, pergjegjsave te zyrave e specialisteve , specifikohen ne menyre analitike sipas misionit per çdo funksion dhe pershkrimin te vendit te punes.

Brenda 30 diteve pas miratimit, te gjitha drejtorite do te bejne pershtatjen e rregulloreve specifike te tyre ne perputhje me detyrat e **“Rregullores se organizimit dhe funksionimit te brendshem te Ministrise”**. Keto rregullore duhet te permbajne pershkrimin e punes per çdo vend pune.

Rregullorja Nr.2551 , date 04.08.2001 shfuqizohet.

Kjo rregullore hyn ne fuqi menjehere.

**MIRATOHET**

**Spartak POÇI**

**MINISTER**